



Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës,
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797
Mail: info@aab-edu.net;
www.aab-edu.net

Ref. nr. 215126 Prishtinë, 23/03/2026

Bazuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili obligon subjektet private me më shumë se 50 të punësuar të caktojnë zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve, si dhe bazuar në Rregulloren për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve të brendshme në Kolegjin AAB, më datën 23/03/2026, Rektori merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim të brendshëm

1. Caktohet: Vlera Osmani në pozitën: Zyrtare përgjegjëse për sinjalizim të brendshëm në Kolegjin AAB.
2. Kontaktet e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim të brendshëm janë: Tel: +383 38 600 005 (ex. 101), E-mail: vlera.osmani@aab-edu.net.
3. Zyrtari përgjegjës për sinjalizim të brendshëm është përgjegjës për pranimin dhe regjistrimin e sinjalizimeve, garantimin e konfidencialitetit të tyre në çdo fazë të trajtimit, zhvillimin dhe ndjekjen e procedurave përkatëse të trajtimit të sinjalizimeve, propozimin e masave të nevojshme në bazë të gjetjeve, mbajtjen e evidencës së saktë dhe të përditësuar si dhe përgatitjen e raporteve vjetore, si dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK).
4. Zyrtari përgjegjës për sinjalizim të brendshëm ushtron detyrën e tij në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje.
5. Kolegji AAB zyrtarit përgjegjës i siguron burimet e nevojshme; qasje në dokumente; mbrojtje nga presionet dhe të gjitha kushtet tjera të nevojshme për kryerjen e detyrës së tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Dr.sc. Blerim Olluri, Rektor

